

BANKA E SHQIPËRISË

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E  
JASHTËM TË EKONOMISË PËR  
NËNTËMUJORIN E VITIT 2006

JANAR 2007



## DEKLARATË PËR SHTYP

### ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR NËNTËMUJORIN E VITIT 2006

JANAR 2007

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për nëntëmujoin e parë të vitit 2006, rezultoi me një tepricë prej 121.1 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit mundësuan në masën 71.4 për qind financimin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Thellim i deficitit korent dhe i atij tregtar.
- Rritje e mjeteve financiare të vendit ndaj jorezidentëve, e shprehur kryesisht në rritje të mjeteve financiare të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë.
- Rritje e rezervave valutore të autoritetit monetar.

#### I. LLOGARIA KORENTE

Vëllimi i transaksioneve korente vlerësohet me një rritje vjetore rreth 14.5 për qind, duke shënuar një nivel prej 5 miliardë eurosh. Mëse 96 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh prej jorezidentëve. Rreth 30 për qind e të ardhurave korente kanë ardhur në formën e transfertave korente, ndërkohë që eksporti i mallrave dhe i shërbimeve ka siguruar përkatësisht 20 për qind dhe 38 për qind të të ardhurave.

Deficiti tregtar si një tipar të përhershëm i zhvillimeve të tregtisë së jashtme, ka diktuar edhe këtë periudhë të vitit, nivelet e larta të deficitit të llogarisë korente. Kështu deficiti korent kundrejt një viti më parë, është rritur me rreth 51.6 për qind, duke regjistruar 410.6 milionë euro. Rritja e deficitit tregtar në mallra dhe në shërbime është balancuar pjesërisht nga rritja e të ardhurave neto në llogaritë e transfertave dhe të të ardhurave faktoriale neto.

##### I. 1. TREGTIA E JASHTME

Aktiviteti tregtar i Shqipërisë gjatë nëntëmujoin të parë të vitit 2006 shënoi një vlerë prej 2.1 miliardë eurosh duke përfaqësuar 42 për qind të vëllimit

të transaksioneve korente të kryera gjatë kësaj periudhe. Orientimi i theksuar i ekonomisë shqiptare drejt importit vazhdon të karakterizojë edhe këtë periudhë, duke rezultuar në thellim të mëtejshëm të deficitit tregtar (18 për qind). Mbulimi i kërkesës së lartë për konsum dhe investime nëpërmjet mallrave të importuar, rritja e vazhdueshme e kredisë për ekomominë gjatë viteve të fundit, si dhe rritja e çmimeve të disa produkteve në tregjet ndërkombëtare mbeten ndër faktorët kryesorë për importe të larta gjatë kësaj periudhe.

Shpenzimet për importe arritën në 1.7 miliardë euro, ndërsa eksportet kontribuan në të ardhura me një vlerë prej 463 milionë eurosh. Të para në dinamikë, ritmet e rritjes si për importet ashtu edhe për eksportet kanë qenë pothuajse në të njëjtat nivele, përkatësisht 17.3 për qind dhe 16.3 qind. Eksportet mundën të mbulojnë vetëm 27 për qind të importeve gjatë këtij nëntëmujori, peshë e njëjtë kjo me periudhën korresponduese të një viti më parë.

Sipas një analize në harmoni me sistemin e llogarive kombëtare, vendi ynë edhe gjatë këtij nëntëmujori mbetet i orientuar drejt mallrave të ndërmjetëm, të cilët zënë afërsisht gjysmën e importeve tona (47 për qind), ndërkohë që mallrat kapitalë dhe ata të konsumit patën përkatësisht këto nivele përfaqësimi, 11 dhe 32 për qind.

Industria e përpunimit aktiv, e cila dominon aktivitetin tregtar të Shqipërisë me botën, njohu tendenca rritëse gjatë kësaj periudhe, pas ngadalësimit të shfaqur gjatë dy viteve të fundit. Pavarësisht rritjes së vazhdueshme të konkurrencës globale nga të tjera vende me kosto të ulët prodhimi (veçanërisht Kina), lekut të fortë si dhe ngadalësimit ekonomik të Italisë dhe Greqisë (tregjet kryesore të eksporteve tona) gjatë kësaj periudhe pothuajse të gjithë sektorët përpunues në vend, kanë pësuar zgjerim. Rritja më e shpejtë ka qenë në kahun e eksporteve me 17 për qind, ndërsa importet e lëndës së parë u rritën me 13 për qind krahasuar me periudhën korresponduese të vitit 2005. Nivelet e përfaqësimit të eksporteve dhe importeve për përpunim të mëtejshëm, ishin përkatësisht 70 për qind dhe 14 për qind kundrejt totalit.

Struktura gjeografike vazhdon të tregojë varësi të theksuar nga tregjet evropiane, rreth 81 për qind të të gjitha transaksioneve tregtare kryhen me këto vende. Përveç partnerëve tradicionalë (Italia dhe Greqia), në kahun e importeve rradhiten Turqia, Kina dhe Gjermania.

Marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit duket se kanë dhënë efektet e tyre edhe në eksporte. Pikërisht janë arritur tregje të reja si Bosnje-Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi, ndërsa eksportet me Kosovën kanë ruajtur trende të qëndrueshme dhe modeste rritjeje.

## I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE.

Tregtia në shërbime, me ritme rritëse gjatë viteve të fundit, po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një element të rëndësishëm të integritimit me jashtë për

Shqipërinë. Transaksionet tregtare në shërbime arritën në rreth 1.9 miliardë euro dhe vlerësohen 22 për qind më të larta, krahasuar me nëntëmujorin e parë të vitit 2005. Llogaria e shërbimeve u mbyll me një bilanc negativ prej 61 milionë eurosh, në rënie (rreth 30 për qind) ndaj deficitit të kësaj kategorie në një vit më parë. Përmirësimi i pozicionit të deficitit të shërbimeve ka ardhur kryesisht si rezultat i tkurrjes së deficitit në “shërbime të tjera”, rrjedhojë kjo e ekspansionit në eksporte të kësaj kategorie shërbimesh.

Deficiti i sivjetshëm në shërbime, i atribuohet një bilanci negativ në kategoritë “shërbime transporti” dhe “shërbime të tjera”, ndërkohë që, kategoria “udhëtime” ka ruajtur pozicionin e saj të suficitit.

Shërbime për “turizëm” (udhëtime), vazhdojnë të kontribuojnë në masë të konsiderueshme flukset hyrëse dhe dalëse të kësaj kategorie, përkatësisht me 69 dhe 61 për qind të totalit për këtë nëntëmujor. Aktualisht, aktiviteti i turizmit përfaqëson një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti në turizëm gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2006, ka gjeneruar rreth 614 milionë euro flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 33 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave. Të ardhurat nga turizmi, për nëntëmujorin, vlerësohet të jenë 19 për qind më të larta kundrejt të njëjtit hark kohor në vitin 2005, të ndikuara kryesisht nga rritja e fluksit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin, si dhe nga rritja e lehtë e koeficientëve vlerësues të shpenzimeve ditore. Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2006, numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur me 26 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Aktiviteti i përshpejtuar vërehet në kahun e shpenzimeve për turizëm, të cilat vitet e fundit kanë shfaqur norma vjetore rritjeje më të larta. Rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 583 milionë euro ose sa 85 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët. Rritja në shpenzimet e udhëtarëve shqiptarë jashtë është më e lartë sesa rritja në të ardhura, duke shkaktuar ngushtimin e bilancit pozitiv të kësaj kategorie nga 38 në 30 milionë euro, në nëntëmujorin e parë të vitit 2006.

Zhvillimet në zërin “shërbime të tjera” me një vëllim prej 21 për qind ndaj vëllimit total, flasin për një aktivitet tregtar në rritje si në të ardhurat ashtu dhe shpenzimet.

Ky nëntëmujor ka regjistruar një deficit prej 29 milionë eurosh, kundrejt deficitit prej 56 milionë eurosh në periudhën e njëjtë të vitit 2005. Eksporti i këtyre shërbimeve është rritur me 50 për qind, ndërsa importi me 20 për qind në krahasim me një vit më parë. Kjo kategori shërbimesh, kryesohet nga transaksionet tregtare në shërbime komunikimi, shërbime kulturore dhe shërbime biznesi.

Bilanci pozitiv i të ardhurave në fund të periudhës, vlerësohet rreth 161 milionë euro ose rreth 60 milionë euro më shumë kundrejt një viti më parë. Ndryshe nga vitet e mëparshme, kur të ardhurat nga puna përbënin kontributin kryesor

në të ardhurat faktoriale neto të vendit, këtë nëntëmujor vërejmë përsheptim të fluksit të të ardhurave nga investimi. Të ardhurat neto nga investimet e portofolit vlerësohet të jenë rritur me rreth 4 herë krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2005, duke kontribuar në masën 80 për qind në rritjen e suficitit të të ardhurave për këtë periudhë. Pjesa tjetër e të ardhurave, që sigurohen nga të ardhurat nga puna, njohu rreth 17 për qind rritje.

Transferrat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë një nga burimet kryesore të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh, dhe gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2006 janë vlerësuar në nivelin 683 milionë euro ose 24 milionë euro më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transferata shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (42 milionë euro), të cilat vlerësohen të kenë ruajtur nivelin e një viti më parë.

## II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Flukset neto të kapitalit, gjatë këtij nëntëmujori, regjistruan rreth 293 milionë euro, duke mundësuar financimin e deficitit korent në masën 71 për qind, si dhe kontribuan në rritje të rezervave valutore. Pas kësaj shifre pozitive qëndrojnë transferatat kapitale hyrëse prej 143.7 milionë eurosh si dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare, prej rreth 150 milionë eurosh.

Llogaria financiare këtë periudhë përkufizohet në rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 320 milionë euro) si dhe rritje të mjeteve tona jashtë (rreth 171 milionë euro). Krahasuar me nëntëmujorin e parë të vitit të kaluar, fluksi i detyrimeve financiare vlerësohet me një rritje prej 39.3 për qind, ndërsa pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës vlerësohen rreth 2 herë më të larta. Megjithatë, fluksi neto i detyrimeve financiare vlerësohet vetëm 5 milionë euro më i lartë se një vit më parë.

Rritja e detyrimeve financiare ndaj botës, këtë nëntëmujor, ka ardhur kryesisht prej flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve direkte (201 milionë euro) dhe huamarrjes me jashtë (me 101 milionë euro).

Investimet e huaja direkte vlerësohen të jenë 25.3 për qind më të larta kundrejt të njëjtit hark kohor në vitin 2005. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit.

Lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat mbeten një faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës, këtë nëntëmujor kanë regjistruar një fluks prej 101 milionë eurosh, prej të cilave vetëm 91 për qind vjen nga huamarrja publike. Ndryshe nga viti i kaluar, përgjatë të cilit është vënë re rritja e detyrimeve të sektorit privat nëpërmjet huamarrjes, këtë nëntëmujor ato janë rritur vetëm me 8.6 milionë, të cilat vlerësohen të jenë vetëm 18 për qind e rritjes së vitit të kaluar.

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 45 milionë euro, të barazvlefshme me 9.7 për qind të eksportit të mallrave.

Nga ana tjetër, pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 171.1 milionë euro. Rritja e mjeteve është përcaktuar kryesisht nga rritje në mjetet e zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, ndërkohë që investime portofoli të njësive rezidente jashtë, kanë ardhur në rënie.

Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit, në fund të periudhës, regjistroi 90.6 milionë euro, me një rënie prej 23 milionë eurosh. Në përbërjen e tyre strukturore sipas monedhave, rreth 78 për qind i përkasin atyre në dollarë amerikanë dhe 17 për qind, në euro.

Mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, këtë nëntëmuor janë rritur me rreth 191 milionë euro. Rritja e këtyre mjeteve ka ardhur si pasojë e rritjes së depozitave të rezidentëve dhe jorezidentëve në sistemin tonë bankar, i cili i ka investuar këto në institucionet financiare jashtë. Gjithashtu, rritja vjen edhe nga zhvendosja e mjeteve nga investime portofoli në depozita me jashtë. Në përbërjen e tyre, depozitat në dollarë amerikanë zënë 60.2 për qind të tyre, ndërsa 35.2 për qind janë në euro.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 121 milionë euro. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u vlerësua në 1 miliard e 294 milionë euro, i mjaftueshëm për të përballuar 4.4 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Bilanci i Pagesave  
në milionë EURO

	9M- 2005	9M- 2006
Llogaria korente	(270.8)	(410.6)
Eksporti i mallrave	398.5	463.3
Importi i mallrave	(1,421.3)	(1,663.2)
Bilanci tregtar	(1,022.7)	(1,199.8)
Shërbimet: kredi	714.1	895.4
Shërbimet: debi	(801.1)	(956.2)
Të ardhurat: kredi	131.3	182.3
Të ardhurat: debi	(31.0)	(21.7)
Transferta private pa shpërblim	696.0	655.2
Transferta shtetërore pa shpërblim	42.7	34.3
Llogaria kapitale	75.1	143.7
Llogaria financiare	135.2	143.8
Investime direkte	160.3	200.8
Investime portofoli	(7.3)	23.3
Kapitale të tjera*	(17.8)	(80.3)
Gabime dhe harresa neto	95.8	238.4
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>44.8</b>	<b>121.1</b>
Rezervat dhe zëra të lidhur me to		
Mjetet e rezervës	(44.7)	(121.1)
Përdorim huash e kredish nga FMN	9.4	5.8
Për t'u mbajtur në vëmendje		
Ndryshimi total në rezerva	20.9	(89.4)
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	(65.6)	(31.8)

\*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.